



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 5, datë 10.02.2026



PËR MIRATIMIN NË PARIM TË VLERËS FINANCIARE TË SHPRONËSIMIT PREJ 473320.05 (KATËRQIND E SHTATËDHJETË E TRE MIJË E TREQIND E NJËZETË PIKË ZERO PESË) LEKË, PËR PASURITË PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA INVESTIMI PUBLIK ME OBJEKT: “RIKONSTRUKSION I RRUGËVE NË QYTET”, PËR RRUGËN “ÇEL ISLAMI”

Mbështetur në Nenin 41 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Urdhrin e kryetarit të bashkisë nr. 66, datë 25.02.2025, “Për ngritjen e grupit të punës, për vlerësimin paraprak të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga investimi publik, me objekt: “Rikonstruksion i rrugëve në qytet”, për rrugën “Çel Islami”, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria Ligjore, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin në parim të vlerës financiare të shpronësimit prej 473320.05 (katërqind e shtatëdhjetë e tre mijë e treqind e njëzetë pikë zero pesë) lekë, për pasuritë pronë private, që preken nga investimi publik me objekt: “Rikonstruksion i rrugëve në qytet”, për rrugën “Çel Islami”, sipas tabelës së hartuar nga grupi i punës, i ngarkuar për kryerjen e vlerësimit paraprak, dhe është pjesë e këtij vendimi.

2. Fondi i shpronësimit me vlerë 473320.05 (katërqind e shtatëdhjetë e tre mijë e treqind e njëzetë pikë zero pesë) lekë, të parashikohet në buxhetin e vitit 2026. Lëvrimi i fondit do të kryhet pasi të jetë botuar VKM-ja për shpronësim.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria Ligjore.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR

Denisa Luarasi



U shpall sot me datë 11.02.2026



LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI
"Rikonstrukcion të rrugëve në qytetin e Durrësit "

P R O N A R I			TË DHËNA HIPOTEKORE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)										VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM				S H Ë N I M E (KUFIZIME HIPOTEKORE, BARRË MBI PASURINË etj.)
N R	Emri	Atësi a	Mbiemri	Fshati ose Qyteti	Z. Kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja Totale	Truall (m2)	Ndërtesë(m2)	Volumi	Faqe	Lloji	Sipërfaqe (m2)	Çmimi (lekë/m2)	Vlera (lekë)	
1	Shtet			Durrës	8512	28/89	Truall	187.86	187.86		20	223	Truall	14.06	19155	0	Regj. Nr. LN. 10.2003, dt.19.10.2003. Nr. Regj. 5432, dt.21.01.2004 pasuria është e okupuar nga Musa Tahir Bllaka.
2	Shtet			Durrës	8512	28/92	Truall	183.49	183.49		20	225	Truall	14.47	19155	0	Regj. Nr. LN. 10.2003, dt.19.10.2003. Nr. Regj. 5432, dt.28.01.2004 pasuria është e okupuar nga Agim Selim Lumi.
3	Shtet			Durrës	8512	28/303	Truall	340.91	340.91		49	40	Truall	3.6	19155	0	Regj. Nr. 13320, dt.07.06.2012.
4	Shtet			Durrës	8512	28/311	Truall	304.17	304.17		49	196	Truall	133.8	19155	0	Regj. Nr. 13674, dt.14.09.2012.
5	Shtet			Durrës	8512	28/91	Truall	321.44	321.44		20	224	Truall	33.65	19155	0	Regj. Nr. LN. 10.2003, dt.19.10.2003. Nr. Regj. 5432, dt.28.01.2004 pasuria është e okupuar nga Kujtim Jangozi.
6	Skënder Arben		Maxhaku	Durrës	8512	28/187	Truall	210.00	210.00		39	82	Truall	15.3	19155	293072	Regj. Nr. 8457, dt.08.12.2006. Vijon nga vol.18,39 fq.237,35



[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

7 Shkëlqim	Durrës		8512	28/312	Truall	500.00	500.00	178.00	49	197	Truall	9.41	19155	180249	Regj. Nr. 13676, dt.14.09.2012. Godinë banimi 3 kat Vijon nga vol.49 fq.193,195 sip. Kati përdhe 178 m2. sip. Kati parë 191.2 m2, sip. Kati dytë 200.3 m2.
	Maxhaku														
Naim															
														TOTAL	473,320.05

GRUPI I PUNES:

ELSA KALESHA

ENLI KAÇULI

ALEKS PRENGA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 140/prot.
5

Durrës, më 18.02.2026

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS

BAS. 18.02.26
DURRËS 1680/F
PROT

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.05 datë 10.02.2026, "Për miratimin në parim të vlerës financiare të shpronësimit prej 473320.05(katërqind e shtatëdhjetë e tre mijë e treqind e njëzet pikë zero pesë) lekë, për pasuritë pronë private, që preken nga investimi publik me objekt: "Rikonstruksion i rrugëve në qytet", për rrugën "Çel Islami".

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI
ADRIAN GURRA

